

Selim Daci

FORCIMI I FAMILJEVE FEUDALE DHE ZOTËRIMET E TYRE NË KRAHINËN E LEZHËS NË SHEKUJT XIII — XIV

Për kohën kur sundimtarët e ndryshëm pushtuan Shqipërinë dhe kur marrëdhëniet feudale arritën lulëzimin e tyre pas copëtimit të mbretërisë së Stefan Dushanit më 1355 në territorin pranë Lezhës u fuqizuan tri familje feudale të mëdha: *Blinishtët*, *Dukagjinët* dhe *Balshajt*.

Familja e *Blinishtëve* të cilën në dokumente e hasim zakonisht në forma të ndryshme dhe të shtrembëruara si: Bleusti, Blenisi, Bletisti, Blevisti. Domeni kryesor i kësaj familjeje ishte fshati i sotëm Blinisht që në vitin 1416 shtrihej në mes të përoit të Gjadrit që ishte në afërsi të Lezhës.¹ Në kohën e sundimit të anzhuinëve më 1274 përmendet i pari i kësaj familjeje Vladi, i cili ishte njëherit edhe si stratiot bizantin dhe në bazë të të dhënave kuptojmë se ishte i lidhur me serbët të cilët edhe i sjellin titullin „kasnec”.² Për shkak se e kundërshtoi pushtetin e Karlit I në vitin 1279, ai kap prej kapitenit Anzhuin të Durrësit dhe u burgos në Brindizi. Kjo rënie vazhdoi për një kohë të shkurtër. Më 1304 duke pranuar vazalitetin ndaj Napolit, ai u bë comes (titull feudal). Me sulmin dhe pushtimin e Durrësit, Filipi i Tarentit, nipi i Karlit I, me qëllim që të vendoste edhe një herë sundimin anzhuin në Shqipëri, shpalli se do t’u siguronte bujarëve dhe kontëve shqiptarë privilegje, të cilat do t’u mundësonin t’i garantojnë të dhënat që iu kishin dhënë më parë nga Karli I Anzhu.³

Në bazë të burimeve kuptojmë se Filipi e fali, për qëndrimin e mëparshëm armiqësor, familjen e blinishtëve dhe u siguroi tokat dhe pronat⁴ dhe i dha nipit të Vladit, Guliem Blinishtit, ofiçin mare-

¹ M. Shufllai, *Serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 33.

² *Po aty*.

³ S. Pulaha, *Vështrim mbi historinë e Lezhës*, Lissus I, Tiranë, 1967, f. 97.

⁴ Dr Ludovicus de Thaloczy, Dr. Constantinus Jireček, Dr. Emilianus Suflay, *Acta et Diplomata Res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, vol. I (amo 344+1343), vol. II (1406) Wiene 1913, nr. dok. 66.

shal i arbërisë (marasealum regni Albanie duximus ordinandum).⁵ Brenda një kohe shumë të shkurtër kjo familje feudale nuk përmendet. Siç duket këtë duhet ta ketë shkaktuar rritja e fuqisë së familjes feudale të balshajve dhe të dukagjinave.⁶

Një familje tjetër feudale që u forcua në Shqipërinë Veriore ishte ajo e *Balshëve*. Lidhur me origjinën e kësaj familjeje është shkruar shumë dhe në mënyra të ndryshme. Sipas burimeve të shkruara dhe analizave kritike të tyre, kjo familje me këtë emër heq origjinën e saj nga një qytet i vjetër i quajtur Balëz (Balletium) në lindje të liqenit të Shkodrës.⁷ Kjo familje në burimet e shkruara daton që nga vitet e fundit të shekullit XIV është me origjinë shqiptarë.⁸ Pas shthurjes së perandorisë serbe, Balsha Plaku me ndihmën e tre djemve të tij, Strazimirit, Gjergjit I dhe Balshës së II mundi të nënshtronte jo vetëm një pjesë të feudalëve shqiptarë, por edhe qytetet, prej të cilave Shkodrën e ktheu në kryeqendrën e tij. Pastajata përfshinë nën sundimit e tyre viset bregdetare të Tivarit, të Budvës si dhe tokat e Zetës. Qëllimi i Balsh Plakut ishte t'ua ndërpresë rrugën trazirave feudale dhe ta bashkojë Shqipërinë,⁹ por këtij qëllimi nuk ia arriti, sepse vdiq në vitin 1362. Pas vdekjes së Balsh Plakut, pushtetin e trashëgoi Strazimiri. Gjatë sundimit të Strazimirit (1362—1372) zotërimet e balshajve u shtrinë në jug të Shkodrës, përfshinë Lezhën dhe zbritën deri në Mat ku ndeshen me kufinjët e principatës së Karl Thopisë në Shqipërinë e Mesme. Pas distatës që pësoi t'Strazimiri më 1364, për të forcuar pozitën e tyre bujare, balshajt kërkuan përkrahjen e papës. Nga dokumentet marrim vesh se këta bujarë i dërguan një letër papës Urbanit V, me anë të së cilës e informojnë se janë të gatshëm për të kaluar nën hirin e saj, nëse ajo i pranon. Papa dha pëlqimin e tij në qershor të vitit 1369 dhe, balshët, siç shihet nga ky dokument, lanë fenë ortodokse dhe u bënë katolikë.¹⁰ Vendin e Strazimirit, që vdiq më 1372, e zuri i vëllai i tij, Gjergji I Balsha (1372—1379). Ky i zgjeroni zotërimet e balshajve gjer në Prizren, kurse në veri, me ndihmën e Karl Thopisë gjer në Bosnje. Nën sundimin e pasardhësit të tij Balshës II, zotërimet e balshajve arritën kulminacionin e vet. Sipas autorit të njohur Athanas Gegës. Balshajt, duke u bashkuar me „Spata”, që, sipas mendimit tonë, duhet të jetë me Spanët, familje feudale në Malësi të Lezhës, dhe me zotërinj të tjerë shqiptarë okupuan një pjesë të madhe të Vukashinit.¹¹ Duke vazhduar depërtimin, ky prijës va-

⁵ *Po aty*.

⁶ M. Shuflai, *vep. cit.*, f. 178; *Histori e Shqipërisë*, vëllimi i parë, f. 207.

⁷ A. Gegaj, *L'Albanie et la invasion turque au XV, e Siecle*, Paris, P. Geuthner, 1937, f. 16; M. Shuflai, *Stadte unde Burgen Albaniens unde haupt-sachlich Wöhrend des Mithelather*, Wiene 1924, f. 25.

⁸ A. Gegaj, *po aty*, f. 16 (lidhur me origjinën e kësaj familjeje shih shënimin 4 *L'Albani...*); S. Rizaj, *Kosova gjatë shek. XV—XVI—XVII*, Prishtinë, 1982, f. 21.

⁹ *Po aty*, f. 16.

¹⁰ *Theines vetera monumenta slaverium meriodionalium*, tom. I. f. 261.

¹¹ A. Gegaj, *L'Albanie*, f. 17.

zhdoi kah Jugu i Shqipërisë dhe pushtoi një pjesë të territoreve të Muzakajve, ku vrau edhe Biogio Matrangën.¹² Brenda një kohe të shkurtër qytetet si Vlora, Kanina dhe Berati, ranë në duar të Balshajve. Balsha II, sundimtari feudal më i shquar i kësaj familjeje, synonte edhe pushtimin e Durrësit, sepse e pengonte shtrirjen e zotërimit të tij në tërë Shqipërinë. Me 1382 Balsha ndërmoi një fushatë luftarake kundër zotëruesit të Durrësit, Karl Thopisë, fushatë, të cilën e përkrahu edhe Republika e Venedikut dhe shteti i Papës por si duket kjo nuk pati sukses. Më 1385 një ushtri turke që kishte 40.000 ushtarë dhe që udhëhiqej nga kapedani i njohur i Bajazitit i quajtur Vrenesi, u drejtua kah Shqipëria. Ajo ishte ftuar edhe nga Karl Thopia, i cili frikësohej nga zgjerimi i zotërimeve të balshajve. Beteja u zhvillua në fushën e Savrës, afër qytetit të Elbasanit. Ushtria shqiptare, më e vogël përkrah numri, qe thyer krejtësisht, ku dhe prisi u vra. Brenda kësaj kohe edhe feudalët dukagjinas u shtrënguan ta njohin epërsinë e balshajve.¹³ Pas vdekjes së Balshës zotërimet e ballshajve u ndanë në dy pjesë: bashkëshortja e Balshës Komita, nga familja e muzakajve, u shkëput nga balshajt dhe, me paqën që lidhi me turqit, ajo u bë sundimtarja e Vlorës dhe e Kaninës (1385—1396) ku edhe vdiq në Vlorë.¹⁴ Lezha qëndroi me balshajt gjer në kohën kur u bë sundimtar Gjergji II Balsha (1385—1403), i cili, duke pasur një pushtet të dobët nuk mundi të mbajë nën kontrollën e vetë feudalët e nënshtruar, siç bënë më parë paraardhësit e tij.¹⁵ Të parët feudalë që ngritën krye ishin Lekë e Pal Dukagjini, të cilët ia shkëputën atij Lezhën më 1387. Autoriteti i tyre u ngrit aq sa raguzanët ishin të lirë për të bërë tregëti me këtë territor dhe detyroheshin t'u paguanin taksën e doganës zotëruesve dukagjinas e jo zotëruesve të mëparshëm. Për këtë qëllim, raguzanët lidhën marrëveshje me dukagjinët në vitin 1387.¹⁶ Edhe Republika e Venedikut e shfrytëzoi rastin e dobësisë së tij dhe kërkoi të dorëzohen Shkodra, Drishti, Danja dhe Kalaja e Satit (Sapa). Gjergji II vdiq më 1403.¹⁷ Balsha III, njëri prej tre djemve të tij, e trashëgoi. Në fillim të sundimit të tij ai e respektoi traktatin e lidhur nga i ati me Republikën e Venedikut, mirëpo më vonë filloi negociatat me turqit. Republika e Venedikut kërkoi paqe me Balshën.¹⁸ Ndërkaq, marrëveshja në mes të Balshës dhe Venedikut nuk duhet të zgjasë shumë, sepse qysh në gusht të vitit 1410 Venedikut iu dasht të merrte masa lidhur me mbrojtjen e Shkodrës nga sulmet e Balshës III. Një vit më vonë, më 1411, Balsha III sulmoi për të dytën herë Kalanë e Shkodrës. Në bazë të kësaj mund

¹² A. Gegaj, *l'Albanie*, f. 18.

¹³ *Orbinus cite par du Cange*, op. cit., f. 292.

¹⁴ A. Gegaj, *l'Albanie*, f. 19.

¹⁵ *Histori e Shqipërisë*, vëllimi i parë, f. 211; *Lissus I*, f. 98.

¹⁶ Dr. Ludovicus de Thaloczy — K. Jireček — M. Shullay, *acta et ... II*, 413, f. 99; *Hist. e Shqipërisë*, vëll. i parë, f. 230.

¹⁷ N. Jorga, *Notes et extraits pour servir l'histoire des croisades*, I—II, Paris, 1899, II, f. 60, nr. dok. 4. Mëtej (N. Jorga — Tom.)

¹⁸ Jorga, *vep. cit.*, II, fq. 163.

të konkludojmë se armiqësia në mes të Venedikut dhe Balshës III është gjithmonë prezente në dokumentet e kohës.¹⁹ Balsha III edhe më tepër vuri në rrezik pasuritë venedikase të Shqipërisë dhe bëri një luftë të pamëshirshme kundër saj.²⁰ Balsha III kërkoi përkrahjen e Kastriotëve dhe të princërve të tjerë shqiptarë.²¹ Republika e Venedikut me përfaqësuesin e vet, që në dokumente njihet me emrin Andre Foskari, bënte presion te feudalët e këtyre anëve si te Andrehoti,²² që mbante disa prona në periferi të Shkodrës dhe Kojazaharinë, poseduesin e qytetit Sati. Mirëpo, kjo ofenzivë diplomatike e Venedikut e inspiroi Balshën III që të përgatitet për t'i sulmuar pasuritë venedikase. Republika e Venedikut më 13 qershor të vitit 1419 i propozoi Stefan Maramontës²³ për ta vrarë Balshën dhe si kompensim ajo i ofroi shumë prej 4000 dukatësh dhe i siguroi trashëgimin e viktimës. Kjo tentativë e likuidimit të Balshës III dështoi dhe Venediku autorizoi më 25 qershor të vitit 1420 Zhak Dandallon për të pranuar ndërmjetësimin e mbretit të Siçelisë.²⁴ Kërcënimi i Balshës e detyroi edhe Venedikun t'u bëjë koncesione fshatrave përreth qytetit të Lezhës, edhe pse nuk ia arriti ta pushtojë këtë qytet.²⁵ Pas vdekjes së Balshës III më 1422, trashëgimtar që reklamuar Stefan Llazareviqi i Serbisë,²⁶ por nga dokumentet kuptojmë se popullsia shqiptare u revoltua nga dominimi i tij. Stevan Cernojeviqi okupoi Ulqinin (Dulcignon) dhe beri kryeqendër Zhabjakun pranë lumit Morava. Ky princ i Malit të Zi u bashkua pastaj me feudalët shqiptarë dhe bëhet besëlidhës besnik i Skënderbeut.²⁷ Zotërimet e balshajve pas vdekjes së Balshës III, i cili nuk la trashëgimtarë, hyjnë nën vartësinë e kastriotëve dhe shtriheshin në mes të Lezhës dhe Krujës.²⁸

Dukagjinët. — Gjer më tani për këtë familje feudale është shkruar dhe botuar një lëndë bukur e gjerë lidhur me origjinën e kësaj familjeje feudale shqiptare. Duke u mbështetur në mënyrë jokritike në tekstet narrative madje, duke mbajtur edhe qëndrimet tendencioze, këtë familje e lidhin edhe me etnogjenezë gjermane.²⁹ Gjenezologjinë e kësaj familjeje në mënyrë më të hollësishme e ka dhënë Karl Hopfi,³⁰ i cili është përpjekur që të dhënat nga librat arkivale venedikase t'i koordinojë me ato të dhëna për lidhjet fa-

¹⁹ Hopf, *vep. cit.*, tomi II, f. 98.

²⁰ Š. Ljubić, (tomi IV), *Listine o odnošaji između južnog slovenstva i mletačke republike*, I—X, Zagreb, 1876—1891, f. 255—56.

²¹ A. Gegaj, *vep. cit.*, f. 20.

²² Jorga, *vep. cit.*, I, f. 253—254, 260.

²³ Š. Ljubić, *vep. cit.*, tom IX, f. 123; N. Jorga, *vep. cit.*, I, f. 506—507.

²⁴ Š. Ljubić, *vep. cit.*, tomi VIII, f. 304—305.

²⁵ L. de Thaloczy, C. Jireček, E. Shufflay, *vep. cit.*, II, nr. 767, f. 238.

²⁶ Š. Ljubić, *vep. cit.*, tom VIII, f. 95—109, 121.

²⁷ A. Gegaj, *vep. cit.*, f. 21.

²⁸ *Po aty*, f. 22.

²⁹ Casteletti, *dans studia Albanezi*, tomi III—IV, 1932, f. 40.

³⁰ Hopf Charles, *Chroniques greko-romanes*, Berlin, 1873, f. 533.

miljare në mes të dinastive të ndryshme shqiptare që i ka shkruar Gjon Muzaka. Sipas historianit të njohur Vikentije Makushevit, kjo familje është e vjetër dhe se në shekullin VII kishin nxitur një revoltë në Bosnjë e sidomos në Raguzë (Dubrovnik), por pas një dështimi iu dasht të tërhiqen nga presioni feudal të Bosnjës.³¹ Përsa i përket emrit Dukagjin,, ai pa dyshim është formuar nga mbiemri Gjin, fisnik arbëresh, dhe titulli Duc (Duca), titull i pranuar nga popujt e lindjes. Më 1281 po ky Gjin Tanushi (Ducem ginium Tanuschum Albanensem) për herë të parë e mbajti këtë titull.³² Në shekullin XIII dukagjinët u dukën përsëri në histori bashkë me Tanush Dukagjinin e parë, i cili pati dy djem, Gjinin dhe Progonin,³³ feudalë të Zadrimës dhe vendeve përreth. Sipas kësaj që thamë, nuk ka kurrfarë zbrazëtie në mes të themeluesit të dukagjinëve dhe dukagjinëve të shekullit XIV, siç thotë historiani i njohur Ivan Bozhiqi,³⁴ sepse në kartën që ua dha më 2 shtator të vitit 1368 dubrovnikasve sundimtari i Kaninës e Viorës, Aleksandri prej bujarëve të tij përmend Prodanj Vojvodën.³⁵ Sipas mendimit tim duhet pranuar mendimin e Karl Hopfit se ky emër duhet lexuar si progon e jo prodan dhe se ky emër figuron edhe tek dukagjinët e mëvonshëm.³⁶ Progon Dukagjini kishte dy djem, Palin I e Lekën I, të cilët janë zotërinj feudalë të Lezhës (Alesios).³⁷ Edhe Skënder Rizaj në punimin e tij të disertacionit pranon se dukagjinët e vërtetë rrjedhin prej dy vëllezërve, Lekës dhe Palit, të cilët kanë vdekur para vitit 1393 dhe të cilët më 1387 u garantuan dubrovnikasve kalim të lirë në territorin e tyre, por me kusht që t'i paguajnë doganat atyre e jo paraardhësve.³⁸ Tre bijtë e Lekës së parë Progoni II, i cili ia dorëzoi Lezhën Venedikut, Gjergji I, zotëri në Zadrimë dhe Tanushi zotëri nga Fandi ndahen në drejtime të ndryshme, që secili do ta luajë rolin e tij në kohën e Skënderbeut.³⁹

Familja e dukagjinëve posedonte një territor të gjerë. Ajo në Veri të Shqipërisë takohet me balshajt, por pas rënies së kësaj dinastie kësaj familjeje iu dasht të luftojë kundër turqve.⁴⁰ Cilat ishin pronat e dukagjinëve dhe territori që e kanë pasur ata? Pas hulumtimeve që kam bërë në lidhje me përpilimin e këtij punimi mendoj se Ivan Bozhiqi⁴¹ nuk ka të drejtë kur polemizon me A. Gegën⁴²

³¹ Vicentije Makushev, *Pamiatniki Dubrovnika*, Petrograd, 1867, 307; Dr. Skënder Rizaj, *Rudarstvo Kosova i susednih krajeva*, f. 23; A. Gegaj, *vep. cit.* f. 13.

³² M. Shuflai, *Serbët dhe shqiptarët*, Tiranë, 1926, f. 189—90; A. Gegaj, *vep. cit.*, f. 12.

³³ S. Ljubić, *vep. cit.*, tomi IV, f. 565.

³⁴ I. Božić, *O dukađinima*, Zbornik Filozofskog fakulteta, knj. VIII, Beograd, 1964.

³⁵ *Po aty*, f. 382; Autorët, *vep. cit.*, II, 57 nr. dok. 249.

³⁶ A. Gegaj, *l'Albanie*, f. 14.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ S. Rizaj, *vep. cit.*, f. 24.

³⁹ A. Gegaj, *vep. cit.*, f. 14.

⁴⁰ *Po aty*, f. 14.

⁴¹ I. Božić, *O dukađinima*, f. 395.

⁴² A. Gegaj, *vep. cit.* f. 13.

kur përmend se pronat e dukagjinëve nuk përfshijnë territorin e sotëm të dukagjinëve, gjegjësisht Pejën, Gjakovën, dhe Prizrenin. Dokumentet osmane të hulumtuara dhe një pjesë e tyre të botuara nga S. Pulahu, vërtetojnë se pronat e dukagjinëve në shekullin XV përfshinin në gjirin e tyre Prizrenin, Gjakovën dhe Pejën.⁴³ Mëtej këtë e ka vërtetuar në punimin e vet edhe Stjepan Antoljaku, i cili thotë se pronat e dukagjinëve përfshinin edhe territorin e Pejës, të Gjakovës dhe të Prizrenit.⁴⁴ Edhe Skënder Rizaj në punimin e tij të disertacionit ka vërtetuar se Prizreni, Gjakova dhe Peja gjatë shekullit XV bënë pjesë në pronat feudale të familjes së dukagjinëve.⁴⁵ Nga kjo që u tha më lart, mund të konkludojmë se autori i këtij punimi, Ivan Bozhiqi, shumë probleme lidhur me familjet shqiptare, gjegjësisht dukagjinët, na i paraqet në mënyrë jo të argumentuar dhe pa baza shkencore, megjithëse bën përpjekje që të tregojë se është mbështetur në të dhëna arkivale të shkruara në gjuhën latine e që ruhen në arkivin qendror të Venedikut dhe të Dubrovnikut. Bie fjala. Bazhiqi thotë se, „sipas një dokumenti“⁴⁶ të vitit 1444 dukagjinët si domen të vetin kishin Zadrimen (rreth pellgut të poshtëm të Drinit deri te lumi Mat) dhe në këtë domen bënte pjesë edhe Mali i Zi. Mendoj se Bozhiqi përsa duket fjalinë (caasti, nominati, montagna, nera) e ka përkthyer gabim ose ka nënkuptuar, sepse fjala është për Malësinë e Mbishkodrës e jo Malin e Zi.⁴⁷

Në territorin shqiptar, ashtu sikurse në Ballkan dhe në vende të tjera, kishte filluar me të madhe grindja feudale. Kjo gjë u shkaktoi edhe te familjet feudale gjatë kësaj kohe. Kështu, në shekullin XV mosmarrëveshja feudale kishte përfshirë familjet e kastroitëve, të zaharive, jonihmëve etj. Familja e dukagjinëve mbante lidhje të ngushta me Republikën e Venedikut dhe shumica e anëtarëve të saj qenë emëruar nga ana e diplomacisë së qytetit të Lagunës, i cili vazhdonte në Shqipëri, si gjetiu, një politikë ekuilibruese në mes të familjeve. Më 1403 Venediku bëri një lidhje me dukagjinët që sinjalizonte dhenien e Lezhes Republikës nga „nobiles Duchaini“ në këmbim me një rentë të ardhurash vjetore prej një të tretës së të ardhurave.⁴⁸

Raportet e mira në mes të Venedikut dhe dukagjinëve u ruajtën për një kohë dhe qenë mjaft stabile. Më 1433 filloi invazioni turk në Shqipërinë Veriore. Po në këtë vit Shqipëria u ngrit kundër këtij invazioni. Isak Skopija ishte atëherë guvernator gje-

⁴³ Selami, P. *Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës vitit 1485*, I, Tiranë, 1974, f. 9—10.

⁴⁴ S. Antoljak, *Sultan Jahja*, Zbornik Filozofskog fakulteta, knj. 13, Skoplje, 1962, f. 121.

⁴⁵ S. Rizaj, *vep. cit.* f. 24.

⁴⁶ I. Božić, *vep. cit.* f. 395.

⁴⁷ S. Ljubić, *Starine* 14—56; Autorët, *vep. cit.*, Acta Albanie I, f. 205, nr. dok. 5.

⁴⁸ N. Jorga II, f. 261, A. Gegaj, *vep. cit.*, f. 14.

neral i sulltanit në Shqipëri, por në Veri të vendit ishte Hasan Begu, i cili në dokumente njihet si ithtar i venedikasve. Në anën tjetër kemi rezistencën e familjes së dukagjinëve në krye me Nikollën I, i cili njëherit ishte edhe vëllai më i vjetër i Tanushit IV, por që dështoi, sepse Republika e Venedikut pëpiqej për ta ruajtur paqen e Sulltan Muratit.

Hasan Begu që i pakënaqur me Venedikun, prandaj mori masa për t'iu kundërvënë Dagnos (Danjos). Për këtë qëllim solli kapetanët e Shkodrës për t'i ndihmuar guvernërit të sulltanit kundër dukagjinëve. Në të njëjtën kohë viceguvernëri i Lezhës mori armët e kërkuara më parë për ta larguar një kohë dukagjinin e parë nga Andrea Topia, me të cilin ishte në lidhje. Republika e Venedikut pati sukses në këtë aspekt dhe përpjekja e kryengritjes dështoi.⁴⁹

Në kohën e Skënderbeut dukagjinët morën pjesë aktive në luftën që u zhvillua kundër Venedikut. Në lidhjen e paqes së vitit 1448 ata qëndruan në ballë të udhëheqësve shqiptarë.⁵⁰ Një prej anëtarëve më të njohur të familjes së dukagjinëve, që është prezent kudo në dokumente, është pa kurrfarë dyshimi Leka, i cili njëherit ishte i biri i Pal Dukagjinit, njeri i matur, energjik dhe armik i rrezikshëm i turqve, organizator i mirë dhe legjislator.⁵¹ Po ky Leka vazhdoi dhe udhëhoqi luftën kundër turqve edhe 10 vjet pas vdekjes së Skënderbeut. Legjendat, toponimet, kanuni e të tjerë, që ende janë të gjalla në popull, dëshmojnë për këtë. Pas pushtimit kurk, shumë anëtarë të kësaj familjeje kaluan në Itali, të tjerët u vunë në shërbim të sulltanit. Nën pushtetin turk arritën poste të larta dhe kishin ndikim të madh në perandori.⁵² Në anën tjetër, duhet cekur se edhe me rënien nën sundimin turk territoret e tyre ishin gjysmë të varura dhe udhëhiqeshin sipas ligjit të Lekës (Kanunit të Lekë Dukagjinit).⁵³

Selim Daci

THE STRENGTHENING OF THE ALBANIAN FEUDAL FAMILIES AND
THEIR POSSESSIONS IN THE ALESSIO (LEZHA) DISTRICT IN THE
XIIIth — XIVth CENTURY

S u m m a r y

In the VIIIth century Alessio belonged to the Durazzo (Durrës) district, but when Stephan Nemanja extended the Serbian Kingdom, Alessio was included in it.

⁴⁹ A. G e g a j, *po aty*, f. 15.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² I. B o ž i ć, *vep. cit.*, f. 424.

⁵³ S. R i z a j, *vep. cit.*, f. 24.

At the beginning of the XIIIth century, Alessio entered under the Despotat of Epirus. Later on, the war between the Despotat of Epirus and the Nikeja Empire weakened the Byzantinium power on the one hand, and Strengthened the Albanian feudal power, on the other hand.

In the XIIIth—XIVth century rulers of Zadrima and the highland of Alessio were the Albanian families such, as the Blinishtet, the Balshajt, and the Dugadjinet. These families were intensified with the prosperity of feudal relations after the partition of Dushan's Kingdom.

Feudal realtions in the Alessio district came to life as a natural phenomenon of economic-social development of the country and not as a result of an outer influence.